

Në bazë të nenit 13, paragrafit 1 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe neni 5 alineja 1 e Rregullores së mënyrës, procedurës dhe kriterëve për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 të datës 28.12.2022, nr. 01-176/3 të datës 1.3.2023, nr. 01-197/3 të datës 15.04.2024, nr. 01-109/3 të datës 11.02.2025 dhe nr. 01-157/4 të datës 25.3.2025, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURS PUBLIK I PËRSËRITUR

Për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues

I. Qendra Shtetërore për provime Shkup shpall konkurs publik për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm - vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore për vitin shkollor 2024/2025, për lëndët:

- 1) Gjuhë angleze – 10 (dhjetë) vlerësues;**
- 2) Gjuhë shqipe dhe letërsi – 7 (shtatë) vlerësues;**
- 3) Gjuhë frënge – 1 (një) vlerësues dhe**
- 4) Gjuhë italiane – 1 (një) vlerësues.**

II. Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer së paku studime akademike të ciklit të parë nga fusha përkatëse;
- të jenë nga radhët e mësimdhënësve të lëndëve përkatëse mësimore në shkollat fillore ose të mesme në RMV dhe
- të kenë së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në mësimdhënie.

III. Kandidatët detyrimisht i dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- fletëparaqitjen e plotësuar (formularin e aplikimit e kenë të paraqitur në ueb-faqen: www.dic.edu.mk);
- certifikatë shtetësie;
- kopje të certifikatës/diplomës për studime të kryera përkatëse akademike të ciklit të parë, e verifikuar në noter dhe
- vërtetim për marrëdhënie pune dhe përvojë përkatëse pune së paku 3 (tre) vjet si mësimdhënës në lëndën përkatëse mësimore në shkollat fillore ose të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në origjinal ose kopje të noterizuar.

IV. Për kandidatët që i plotësojnë kushtet e lartpërmendura, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup do të organizojë trajnim, pastaj do të verifikohen shkathtësitë dhe saktësia e kandidatëve gjatë vlerësimit të përgjigjeve/zgjidhjeve të nxënësve.

Kandidatët që nuk kanë marrë pjesë në trajnim, nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtejme.

Për vlerësimin e testeve nga pjesa eksterne të maturës shtetërore Qendra zgjedh vlerësues nga radhët e mësimdhënësve të shkollave të mesme që realizojnë mësimdhënie sipas lëndës që vlerësohet.

Me përjashtim, nëse për vlerësues nuk mund të sigurohet mësimdhënës nga shkollat e mesme, përcaktohet mësimdhënës nga shkolla fillore, me arsimim të lartë të kryer dhe që realizon mësimdhënien sipas lëndës që vlerësohet.

V. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues kryhet në mënyrë dhe procedurë të paraparë sipas Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

VI. Kandidatët që do të përzgjidhen për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues do të jenë të angazhuar deri më 30.09.2025.

VII. Afati i paraqitjes nga kandidatët e interesuar është 5 (pesë) ditë.

VIII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të përfundojë më së voni në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit të paraqitjes.

IX. Dokumentacioni i vonuar, i pa plotë dhe i pavlefshëm nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

X. Fletëparaqitja e plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri më 14:00) ose me dërgesë të rekomanduar postare në adresën në vijim: Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup, rr. Vasil Gjorgov” p.n. 1000 Shkup, me shënimin “**Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues për lëndën ...**” (shënohet lënda për vlerësimin e të cilit paraqiten kandidatët).

XI. Informacione shtesë për konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 075/258-862, çdo ditë pune nga ora 10.00 deri më ora 14.00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE SHKUP